



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 267/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë duke vendosur përkitazi me ankesën e Rjetit Ballkanik për Gazetari Huluntuëse (BIRN) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Podujevë, për shkak të bërjes së fushatës gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Hidhet poshtë si e pa rregullt ankesa e Rjetit Ballkanik për Gazetari Huluntuëse (BIRN) me seli në Prishtinë.

Arsyetim

Me datën 09.06.2014, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN në të cilën pretendohet se, në Podujevë, në shkollën e mesme teknike “Fan Noli” është vërejtur një bibord i subjektit politik LDK. Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi. Në bazë të nenit 4.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it e njoftoi palën lidhur me kërkesën për përgjigje në ankesë Anr.267/14, ku i jepet e drejta për tu përgjigjur në ankesë deri me datë 11.06.2014 deri në ora 10:00. PZAP-i e pranoi përgjigjen në ankesë nga subjekti politik LDK në të cilin theksohet se bilbordi ishte i vendosur që nga fillimi i fushatës zgjedhore jashtë rrethojës së shkollës dhe se me kurfar qëllimi nuk është i vendosur në ditën e zgjedhjeve. Pra të njëjtat bilborde jashtë rrethojave të shkollave egzistojnë edhe në tërë Kosovën.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj rregullsinë e ankesës gjeti se:

ankesa është e pa rregullt

PZAP-i, konstatoi se ankesa në fjalë është e pa rregullt pasi që sipas nenit 3.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, parashihet që “Ankesat duhet të dorëzohet me shkrim dhe të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij/saj”, ndërsa në rastin konkret ankesa nuk është e nënshkruar nga parashtruesi i ankesës .

PZAP-i në kuptim të nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në nenin 118.1 të LZP-së lidhur me ankesën e lartpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

Anr.267/2014 më datën 12.06.2014

Kryesuesi i Panelit

Muhamet Rexha



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*